



**INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT**

**FUSHA: GJUHËT E HUAJA**

**LËNDA: ITALISHT**

**KODI: 3.3**

**PROGRAMI I LËNDËS ITALISHT PËR KLASËN E 10**

**TIRANË, SHTATOR 2008**

Mësimi i gjuhëve të huaja ndihmon në mënyrë të veçantë në formimin e përgjithshëm të nxënësit. Ai shton mundësitë shprehëse të tij, e pajis atë me mjetet dhe metodologjinë e përshtatshme të komunikimit, që do t'i shërbejë për t'u ndërfutur në shkëmbime të shumëllojshme etj.

Programi i gjuhës italiane për klasën X ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, të nxënies dhe të vlerësimit të nxënësit në nivelin gjuhësor B1, sipas tabelës së vlerësimit në kuadrin e përgjithshëm evropian për gjuhët.

Programi, për nga struktura dhe organizimi, reflekton sugjerimet e Institutit të Kurikulës dhe të Trajnimit; ai është mbështetur përgjithësisht në strukturën e parashtruar në *Kurikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar* (1999), si dhe në konceptimin dhe metodologjinë e *Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët* dhe në *Kurikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar*.

Programi i klasës X ravigjzon të gjitha njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përfutuara nga klasa III deri në klasën IX, duke nxjerrë në pah baraspeshën e njohjes së gjuhës italiane me nevojën e nxënësit për t'i thelluar këto dije dhe, njëkohësisht, për të rritur aftësitë e tij shprehëse në gjuhën italiane drejt formimit të tij si përdorues i pavarur.

Duke qenë se mësimi i një gjuhe është në të njëjtën kohë edhe njohje e kulturës apo e kulturave të tjera, ai bën të mundur edhe rritjen e horizontit kulturor e formues të nxënësit dhe ndikon drejtpërsëdrejti në formimin e personalitetit të tij. Programi ndërtohet mbi tematikën që lidhet me interesat dhe karakteristikat e grup-moshës dhe kontribuon në zhvillimin e pavarur, intelektual dhe socio-kulturor të nxënësve.

Programi i gjuhës italiane për klasën X ka si synim zhvillimin gjuhësor, intelektual dhe kulturor të nxënësit, në mënyrë që ai të jetë i aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës.

Ai synon të zhvillojë të menduarit kritik dhe pavarësinë e nxënësit në kontekstin e klasës dhe jashtë saj, duke nxitur forma të ndryshme të punës individuale dhe të ndërveprimit në çifte e grupe.

Njohuritë e përfutuara në këtë program, si pjesë përbërëse e kurikulës së re të arsimit të mesëm të lartë, mundësojnë rritjen dhe forcimin e njohurive të nxënësit jo vetëm në gjuhën italiane, por edhe në lëndët e tjera, si, p.sh., në lëndët e historisë, të gjeografisë, të biologjisë etj., duke i ndërthurur këto dije në mënyrë logjike. Kjo ndërthurje ndërlëndore fiton një dimension të ri në përpjekjen për të siguruar dije të qëndrueshme dhe të vazhdueshme. Këto dije e përgatitin nxënësin, gjithashtu, për t'u përballur me studime të mëtejshme, si dhe me situata punësimi brenda dhe jashtë vendit.

Mësimi të gjuhës italiane i janë kushtuar 3 orë javore, me një numër të përgjithshëm prej 108 orësh vjetore. Programi i gjuhës italiane për klasën X është konceptuar e përpiluar në mënyrë të tillë që, me anë të dijeve që merr gjatë procesit mësimor, nxënësi të zhvillojë personalitetin e tij, duke rritur besimin dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe shoqërisë.

## **1. SYNIMET**

Programi i gjuhës italiane për klasën e dhjetë synon që nxënësi:

- të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendeve italishtfolëse dhe kulturës amtare;
- të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme;
- të forcojë ndërveprimin në situata reale dhe jashtëshkollore, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore;
- të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

## 2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Programi i gjuhës italiane për klasën X ka si objektiva të përgjithshëm të pasqyrojë dhe të ndërthurë njohuritë e gjuhës italiane me njohuritë e lëndëve të tjera, duke zhvilluar te nxënësi:

- shkathhtësinë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim dhe me gojë;
- aftësinë për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- aftësinë për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme.

## 3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE

**36 javë x 3 orë = 108 orë**

### a) Objektiva sipas standardit në komunikim

*Përshkrimi:* Objektivat e standardeve në këtë fushë zhvillojnë më tej bazat e gjuhës, të cilat janë dhënë në ciklin e mesëm të ulët, si domosdoshmëri për një komunikim me një standard më të lartë gjuhësor. Nëpërmjet situatave të ndryshme, të përshtatshme për grupmoshën, kjo standardi i mundëson nxënësit të përftojë njohuri gjuhësore të nevojshme për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm në një mjedis gjuhësor e kulturor italishtfolës.

Standardi në këtë fushë pasuron dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

Standardi në:	Objektiva
<b>Komunikimi</b>	<p><b>Në fund të klasës X nxënës/i,-ja aftësohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të hamendësojë;</li> <li>▪ të ndjekë biseda;</li> <li>▪ të kuptojë thelbin;</li> <li>▪ të kuptojë detaje;</li> <li>▪ të sqarojë;</li> <li>▪ të këmbëjë;</li> <li>▪ të miratojë;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përcjellë informacion;</li> <li>▪ të shprehë pikëpamjet;</li> <li>▪ të krahasojë;</li> <li>▪ të bëjë dallimin;</li> <li>▪ të klasifikojë;</li> <li>▪ të shprehë ndërvarjen e veprimeve, të fakteve etj.;</li> <li>▪ të diskutojë;</li> <li>▪ të debatojë;</li> <li>▪ të tregojë;</li> <li>▪ të përsërisë;</li> <li>▪ të ndërveprojë;</li> <li>▪ të shkruajë;</li> <li>▪ të hartojë;</li> <li>▪ të përshkruajë;</li> <li>▪ të përmbledhë;</li> <li>▪ të bëjë kërkime;</li> <li>▪ të nxjerrë përfundime</li> </ul> <p>në situata të ndryshme, si, p.sh., jeta e përditshme, jeta në shkollë, bota përreth nesh, bota e komunikimit, jeta personale dhe shoqërore etj.</p>
<p><b>Aktet/funksionet komunikimit</b></p> <p><b>(25 orë)</b></p>	<p><b>Në përfundim të klasës së X, nxënës/i, -ja aftësohet</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të miratojë;</li> <li>▪ të kundërshtojë;</li> <li>▪ të kërkojë dhe të japë leje;</li> <li>▪ të urojë;</li> <li>▪ të bëjë hipoteza;</li> <li>▪ të shprehë keqardhje dhe dëshira;</li> <li>▪ të falë dhe të kërkojë falje;</li> <li>▪ të nxisë;</li> <li>▪ të shprehë pëlqime dhe mospëlqime</li> </ul> <p>për përvoja të ndryshme, në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, ekskursione etj.</p>

**b)Objektiva sipas standardit në Kulturë**

Standardi në:	Objektivat
Kulturë	<p><b>Në përfundim të klasës së X, nxënësi aftësohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë sipas regjistrave të ndryshëm të gjuhës (zyrtare, miqësore, normale, informale, etj) rregullat e mirësjelljes të popullit, gjuhën e të cilit</li> </ul>

	<p>mëson,(përdorim i nuancuar i urimeve, përshëndetjeve, fjalëve të urta, etj)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të kërkojë fjalën në publik si dhe të përdorë si duhet gjestet, pozicionin që shoqërojnë ligjërimin.</li> <li>• të shmangë format urdhëruese të drejtpërdrejta duke i zbutur ato me kushtoren sa herë që shpreh një kërkesë; të dijë si të përdorë pasthirrmat, etj</li> <li>• të njohë monumente të artit, personalitete, ngjarje të rëndësishme të historisë dhe të aktualitetit.</li> <li>• të mund të flasë për shijet e të rinjve, tregun, çmimet, modën, etj.</li> <li>• të njohë, kinemanë, apo këngën italiane dhe të mund të bëjë komente mbi to (të shprehë admirimin, pëlqim, mospëlqim, shije të tjera)</li> </ul>
--	--

**c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor**

*Përshkrimi:* Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënësin të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit B1+. Nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, nxënësi nxitet të praktikojë struktura gramatikore të gjuhës italiane, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre. Këtu vihet theksi në përpunimin e njohurive gramatikore të përfuara në nivelet e mëparshme gjuhësore, në dhënien e strukturave të reja gjuhësore, si dhe në përdorimin e tyre në situata më të ndërlikuara.

**Orë të sugjeruara: 23 orë**

Standardi në:	Objektiva
<b>Strukturën gramatikore</b>	<p><b>Në fund të klasës X nxënësi aftësohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të dallojë;</li> <li>▪ të zgjedhë;</li> <li>▪ të shkruajë;</li> <li>▪ të tregojë;</li> <li>▪ të riprodhojë;</li> <li>▪ të ngrëjë hipoteza;</li> <li>▪ të përdorë....</li> </ul> <p>format dhe strukturat gramatikore që në formë rekomanduese, do të ishin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjinia dhe numri i parregullt i emrave, dhe mbiemrave.</li> <li>▪ Pyetësorët (<i>chi?, che cosa?, perché?, dove?</i> etj.).</li> <li>▪ Thirrmosorët (<i>quanto!, come!</i> etj.).</li> <li>▪ Ndajfolje të ndryshme vendi, kohe, mënyre, cilësie etj.</li> <li>▪ Parafjalë të thjeshta e të përbëra që shprehin</li> </ul>

	<p>vend, kohë e marrëdhënie të tjera.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kohët e përbëra të foljes në dëftore (<i>piuccheperfetto</i>).</li> <li>▪ Përdorime me foljet vetvetore përemërore.</li> <li>▪ Përemrat lidhorë.</li> <li>▪ Mënyra kushtore e foljes (e tashme dhe e kryer).</li> <li>▪ Mënyra lidhore (e tashme, e kryer, e pakryer, më se e kryer).</li> <li>▪ Mbiemrat dhe përemrat e pacaktuar.</li> <li>▪ Përshtatje kohësh dhe mënyrash me dëftoren dhe me lidhoren.</li> </ul>
--	--

#### 4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Objektivat e programit të gjuhës italiane të klasës X përcaktohen me hollësi sipas aftësive, linjave dhe nënlinjave.

Është e rëndësishme të theksohet se objektivat lipset të jenë sa më të matshëm dhe konkretë për nivelin dhe moshën e nxënësve që përfshihen në klasën X, si për shembull:

*Objektivi: Nxënësi mund të shkruajë shënime dhe letra personale për të kërkuar ose transmetuar informacione me interes imediat si edhe të bëjë të qarta pikat që i konsideron si më të rëndësishmet.*

Ky objektivi nuk arrihet në mënyrë të njëjtë nga nxënësit. Brenda klasës ka nivele të ndryshme: i ulët, i mesëm dhe i lartë. Nxënësi me nivel të ulët gjuhësor për objektivin në fjalë arrin të shkruajë një letër personale me koherencë deri diku të pranueshme, duke mos përjashtuar edhe gabimet gjuhësore; ai me nivel mesatar përdor një strukturë fjalie më të ndërlikuar dhe ka një koherencë tekstore më të lartë. Ndërkaq, nxënësi i nivelit të lartë arrin të përshkruajë ndjenja, dëshira e fakte, duke argumentuar e kundërshtuar, me qartësi e korrektesë në rrafshin e gjuhës dhe të ndërtimit të tekstit. Nuk duhet të harrohet për asnjë çast se të gjithëve duhet t'u jepet mundësia të përfshihen në detyra të këtilla, me qëllim që të shprehin dhe të realizojnë vetveten, të shkëmbehen e të ballafaqohen me njëri-tjetrin.

Aftësia	Objektiva
<b>Të dëgjuarit</b>	<p><b>Në fund të klasës X nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të tregojë pikat themelore kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde, për tema të njohura që kanë lidhje me punën, shkollën, kohën e lirë etj.</li> <li>- të përshkruajë thelbin e një numri emisionesh në radio ose TV për aktualitetin ose për tema me interes personal, kur gjuha ndjek një shqiptim të ngadaltë dhe të qartë.</li> <li>- të marrë pjesë në një ligjëratë të shqiptuar qartë gjatë një bisede të përditshme, por duke kërkuar herë pas here përsëritjen e ndonjë fjale ose</li> </ul>

	<p>shprehjeje.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të ndjekë planin e përgjithshëm të një parashtrimi të shkurtër për tema të njohura, me kusht që gjuha të jetë standarde dhe e shqiptuar qartë.</li> <li>- të shpjegojë një informacion faktik të drejtpërdrejtë për tema të jetës së përditshme, duke kapur mesazhet e përgjithshme dhe hollësitë, me kusht që shqiptimi të jetë i qartë dhe theksi normal.</li> </ul>
<b>Të lexuarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë tekste që përmbajnë një gjuhë të përditshme lidhur me punën, shkollën dhe kohën e lirë.</li> <li>- të përshkruajë ngjarje, ndjenja dhe urime familjare nëpër letra personale.</li> <li>- të identifikojë fjalë të panjohura me ndihmën e kontekstit për tema që kanë lidhje me interesat e tij.</li> <li>- të nxjerrë nga konteksti, me raste, kuptimin e fjalëve të panjohura dhe, për rrjedhojë, kuptimin e fjalisë, me kusht që tema të jetë e njohur.</li> <li>- të lexojë një tekst të gjatë për të gjetur një informacion që kërkon dhe mund të mbledhë informacione nga pjesë të ndryshme të tekstit ose të teksteve, për të realizuar një detyrë të ngarkuar.</li> <li>- të thotë përshkrimin e një ngjarjeje, të ndjenjave dhe të dëshirave, në mënyrë të mjaftueshme për të mbajtur një korrespondencë të rregullt me një shok a shoqe.</li> <li>- të dallojë pikat themelore të një artikulli gazete jo kompleks në gjuhën italiane, për një temë të njohur.</li> <li>- të zbatojë mënyrën e përdorimit të një aparati apo pajisjeje, nga një manual, teksti i të cilit është jo i ndërlikuar dhe i hartuar qartë.</li> </ul>
<b>Të folurit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të përballojë shumicën e situatave në të cilat mund të gjendet gjatë një udhëtimi në një vend ku flitet gjuha italiane;</li> <li>- të marrë pjesë pa u përgatitur në një bisedë për tema të njohura ose me interes vetjak ose që kanë lidhje me jetën e përditshme (për shembull familja, koha e lirë, aktualiteti, udhëtimet etj.);</li> <li>- të shprehet në mënyrë të thjeshtë, për të treguar veprime dhe ngjarje, ëndrra dhe shpresa, qëllime etj.</li> <li>- të shprehë shkurt arsye dhe shpjegime mendimesh, opinionesh e idesh;</li> <li>- të tregojë një histori, një tregim, një film etj. dhe të</li> </ul>

	<p>shprehë reagime lidhur me rrëfime të tilla.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të komunikojë me njëfarë sigurie për tema të njohura, të zakonshme ose që nuk janë të lidhura me fushat e tij të interesit.</li> <li>- të shkëmbejë, të verifikojë dhe të konfirmojë informacione, të shprehë mendimin e tij për një temë abstrakte ose kulturore, si filmat, muzika, librat etj.</li> <li>- të komentojë shkurt pikëpamjen e dikujt dhe të shpjegojë arsyen përse diçka përbën një problem.</li> <li>- të krahasojë ose të ballafaqojë alternativa, duke diskutuar se ç' duhet bërë, ku duhet shkuar, cili duhet caktuar, cili duhet zgjedhur etj.</li> </ul>
<b>Të shkruarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruajë një tekst të thjeshtë dhe koherent për tema të njohura dhe me interes vetjak.</li> <li>- të shkruajë letra personale për të përshkruar përvoja dhe përshtypje vetjake.</li> <li>- të sjellë informacion për tema abstrakte dhe konkrete, të kontrollojë informacionin dhe ta paraqesë atë me mjaft saktësi.</li> <li>- të shkruajë shënime dhe letra personale për të kërkuar ose transmetuar informacione me interes imediat si edhe të bëjë të qarta pikat që i konsideron si më të rëndësishmet.</li> <li>- të marrë një mesazh që ka të bëjë me një kërkesë informacioni ose me shpjegimin e një problemi.</li> </ul>

## 5. KËRKESA TË GJUHËS ITALIANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i gjuhës italiane për klasën X mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore, në përgjithësi dhe të katër aftësive (dëgjimit, leximit, të folurit e të shkruarit), në veçanti.

Konceptet dhe njohuritë e tjera gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, që lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës italiane e të trajtuara në lëndët e tjera.

1. Kjo ndërthurje e gjuhës së huaj me *matematikën* shprehet në mësimin e shifrave, numrave, veprimeve matematikore në gjuhë të huaj.
2. Lidhja e gjuhës së huaj me shkencat natyrore, si, p.sh., me lëndën e *biologjisë*, reflektohet në trajtimin e linjës “Komunikimi dhe formimi kulturor”.
3. Nga lënda e *TIK-ut*, gjuha e huaj kërkon që nxënësi të kuptojë dhe përdorë terminologjinë që lidhet me lëndën e TIK në funksion të prezantimit të informacioneve të ndryshme.
4. Me *artet* janë të lidhura ngushtë temat për sportin, muzikën, modën, pikturën, si pjesë e fushës tematike “Jeta e përditshme”.



5. Me *shkencat sociale* janë të lidhura tema, si: miqësia, marrëdhëniet familjare, festat etj., që janë pjesë të fushës tematike “Jeta personale e shoqërore”.

Trajtimi ndërëndor u shërben synimeve të përgjithshme të programit, si dhe realizimit të objektivave të linjave dhe të nënlinjave të tij, kryesisht për:

**Edukimin intelektual:** Përmes ndërthurjes së njohurive të ndryshme nxënësit arrijnë të zbulojnë, të analizojnë, të sintetizojnë dhe të vlerësojnë, duke rritur cilësinë e nxënies.

**Edukimin mjedisor:** Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

**Edukimin kulturor dhe etik:** Përmes lëndëve historike dhe gjeografike, nxënësit fitojnë njohuri për popullsinë italishtfolëse. Këto njohuri ndërthuren me dijet për kulturën e këtyre vendeve, për zakonet e doket e tyre, për mënyrën e jetesës etj. Këtu nuk mund të lihen pa përmendur edhe shprehjet etike të këtyre popujve. Nxënës/it,-et mësohen të ndërveprojnë në situata të ndryshme me sjellje etike të përshtatshme, që trajtohen përmes funksioneve gjuhësore, si: të kërkojnë falje e sqarime, të pyesin etj.

**Edukimin për të drejtat e njeriut:** Njohja e kulturave të popullsisë italishtfolëse trajtohet ngushtë me temat e barazisë sociale, të diskriminimit social, të respektit reciprok etj.

**Atdhedashurinë:** Duke njohur kulturën e popullsisë italishtfolëse, nxënësit bëjnë krahasime me kulturën amtare dhe ndërgegjësohen për identitetin e tyre kombëtar.

## 6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës italiane. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurikulare ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurikulare, ashtu edhe te standardet e fushës. Programi i klasës X orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës italiane në nivelin B1+.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- + synimeve të përgjithshme të kurikulës së gjimnazit,
- + synimeve të linjave ndërkurikulare,
- + vlerësimit të nxënësit me notë,
- + parimeve të mësimdhënie-nxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurikulare, standardet e fushës së të nxënies dhe programi lëndor) të zbatohet më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së gjuhës italiane për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse. Përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja, gjithashtu, të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënies dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Mësuesi është i lirë të përdorë një larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/nxënies për t’ua përshtatur nevojave të nxënësit në klasa të ndryshme. Ai i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencës gjuhësore e komunikuese si edhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënësit në

vijueshmëri të këtij procesi. Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën e komunikimit, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe situacionale, me prirjen për t'iu përshtatur sa më afër jetës reale etj. Këto metoda realizohen nëpërmjet strategjive dhe teknikave të ndryshme, sipas aftësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit).

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

### **Strategjitë e të nxënimit**

Për të zhvilluar aftësitë përkatëse, nxënësi ushtrohet të ndjekë këto strategji:

#### **Të dëgjuarit**

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit.
- Të klasifikojë çështjet që dëgjon.
- Të përqendrohet e të zbulojë detaje specifike.
- Të hamendësojë çfarë flitet në magnetofon.
- Të arsyetojë mbi bazën e asaj që dëgjon.
- Të përdorë njohuritë e tij të mëparshme.
- Të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor.
- Të dëgjojë një tregim, këngë etj. disa herë, për të kuptuar idenë kryesore, duke u përqendruar në fjalët e rëndësishme, në rastin kur nuk kupton gjithçka.
- Të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit.
- Të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit.
- Të përpiqet që gjatë dëgjimit të kuptojë referencat kulturore jo të njohura për të, duke përdorur kontekstin për të hamendësuar se kujt i referohen ato.

#### **Të folurit**

- T'i kërkojë folësit të përsërisë atë që sapo ka thënë, në rastet kur nuk e ka kuptuar.
- Të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura.
- Të përdorë shprehje të ndërallura, si: *hm, beh', un non so che, senti, ascolti, capisci* etj., me qëllim që të fitojë kohë në gjetjen e fjalës së duhur.
- Të përsërisë një pjesë të asaj çka thotë bashkëfolësi, për të miratuar se biseda ndërmyjet tyre po përcillet në mënyrë të drejtë kuptimore.
- Të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.

#### **Të lexuarit**

- Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimit, dy rreshtat e parë të mësimit.
- Të lexojë tekstin për herë të dytë, që të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura.
- Të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme.
- Të gjejë përgjigjet e pyetjeve në tekst, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve.
- Të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor.
- Të përdorë përshkrimin me fjalë të njohura, kur nuk di kuptimin e një fjale të dhënë.

- Të bëjë bisedë të ndërsjellë me bashkëbiseduesin.
- Të mbajë shënime gjatë një bisede apo diskutimi, për të përmbledhur mendimin e tij.

### **Të shkruarit**

- Të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar.
- Të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf.
- Të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.
- Të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse.
- Të redaktojë shkrimin e tij ose të këmbëjë punën e tij më atë të shokut.

### **Orët mësimore**

Programi i gjuhës italiane për klasën X është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-nxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Kjo do të thotë se mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës italiane afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive(gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

### **Shpërndarja e orëve mësimore**

Gjuha italiane për klasën X zhvillohet me 3 orë mësimore në javë (36 javë x 3 orë = 108 orë vjetore) dhe shpërndarja e orëve të planifikuara sipas linjave dhe nënlinjave është si vijon:

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në kapituj e njësi mësimore) linjat dhe nënlinjat ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një kapitulli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes në tabelën e shpërndarjes së orëve.

**Komunikimi dhe formimi kulturor** zë 85 orë, të cilat ndahen, sipas nënlinjave që u përgjigjen, 60 orë mësimore për Kulturën dhe komunikimin (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 42 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 18 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse apo ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 25 orë për Aktet dhe funksionet e komunikimit (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 18 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 7 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Në këtë linjë mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th., ai jep detyra komplekse ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas linjave dhe nënlinjave në një kapitull.)

Në linja dhe nënlinja orët e përgjithshme për përpunimin e lëndës janë 31 orë, nga të cilat 5% e tyre, d.m.th. 6 orë, do të përdoren për përpunimin e të gjithë lëndës, ku

vlerësimi tërësor i lëndës zë vendin e tij (p.sh., 3 orë mund të përdoren për përsëritjen dhe 3 orë për vlerësimin me shkrim dhe me gojë të dijeve që kanë fituar nxënësit gjatë procesit të nxënies).

**Formimi gjuhësor zë 23 orë.** Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 16 orë mësimore, do të shfrytëzohen për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 7 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

Përbajtja mësimore e lëndës së gjuhës italiane për klasën X, si vijuese e nivelit A1 deri në B1 në arsimin e ciklit 9-vjeçar, realizohet përmes linjave dhe nënlinjave, duke u orientuar në këtë fazë të arsimit të mesëm të lartë në nivelin B1+ .

### **Përpunimi i njohurive**

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë,
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e fituara më parë;
- integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen vjetore;
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore dhe të të menduarit kritik e krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, si, p.sh., të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimin etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

### **Metodologjia e zbatimit të programit**

Zbatimi i programit mbështetet në parimet e mëposhtme:

#### **Vendosja e nxënësit në qendër të vëmendjes**

Programi merr parasysh nxënësin, njohuritë e tij, aftësitë e grup-moshës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake. Kjo reflektohet, së pari, në përzgjedhjen e temave që trajtohen, së dyti, në përdorimin e strategjive që e nxisin nxënësin të veprojë me gjuhën, së treti, në përfshirjen e tij në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përfutuara.

### **Krijimi i mjedisit të të nxënit**

Krijimi i një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, ku nxënësi ndjehet i sigurt, mundëson një mësimdhënie/nxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuar më parë.

### **Organizimi i klasës**

Mësuesi përdor mënyra të ndryshme të organizimit të klasës, që krijojnë e ruajnë një mjedis mbështetës dhe rrisin motivimin e nxënësve. Organizimi i mësimin mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atyre u krijohen mundësi ose lehtësi për të eksploruar në gjuhë, për të eksperimentuar në të, për ta përdorur atë në përputhje me nevojat e tyre. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënësit, si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënësi ndërkohë mëson edhe nga shokët e tij. Herë pas here, nxënësi punon në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

### **Të mësuarit bashkëveprues**

Nxënësi gjatë orëve të gjuhës së huaj shpesh nxitet të punojë së bashku me të tjerët. Detyrat e përbashkëta u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur me njëri-tjetrin, ndihmojnë të folurit e rrjedhshëm dhe formojnë shkathtësi sociale. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe ndihmon, gjithashtu, në shoqërizimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesit, nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

### **Përdorimi i gjuhës në klasë**

Gjuha italiane është mbizotëruese gjatë orës së mësimin. Mësuesi, që është nxitësi dhe mbështetësi kryesor i përdorimit të gjuhës italiane në klasë, minimizon përdorimin e gjuhës amtare, të cilën e përdor vetëm kur është e domosdoshme, në funksion të shpjegimit të një kuptimi gramatikor a leksikor, të një ballafaqimi ndërgjuhësor, të një përkthimi pedagogjik etj.

### **Të mësuarit e gramatikës**

Nevojat e veçanta për komunikim mbështeten në gramatikën komunikuese. Nxënësit e mësojnë gramatikën në shërbim të komunikimit. Në këtë nivel jepet një sasi e vogël rregullash gramatikore për t'u mësuar, gjithmonë në mënyrë të tillë që nxënësit të mund të përdorin format gramatikore për qëllime komunikimi. Gramatika jepet dhe mësohet në mënyrë induktive, nëpërmjet materialeve autentike. Nxënësit, gjatë të gjithë procesit të të nxënit, ekspozohen ndaj strukturave dhe formave të reja gramatikore.

### **Qortimi i gabimeve**

Gabimet duhet të qortohen, por kjo në kohën dhe vendin e duhur. Vërejtjet, këshillat dhe qortimet e mësuesit, të shokëve ose dhe të vetë nxënësit ndihmojnë për të nxitur vetëbesimin dhe vëterespektin. Qortimi pa kriter mund të çojë në frenimin e iniciativës, në heqjen e dëshirës për të folur, në demotivimin, madje mund të rrezikojë edhe ecurinë e mëtejshme të mësimin. Mësuesi ndërhyt me takt, dhe, duke përdorur forma të larmishme,

qorton më shpesh kur nxënësit praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë kur nxënësit janë duke punuar në grup, kur janë duke debatuar ose duke diskutuar për tema të ndryshme.

### **Puna e diferencuar me nxënësit**

Më qëllim që metodat e mësimdhënies/nxënies, parimet dhe strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësuesi planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Duhet të pranojmë se niveli i formimit të aftësive të nxënësve që i nënshtrohen programit të gjuhës italiane të klasës X nuk është i njëjtë për të gjithë nxënësit. Arritja e rezultateve të kërkuara nga programi për të gjithë nxënësit kërkon që mësuesi të marrë parasysh nivelet e ndryshme që ekzistojnë në klasë. Kjo gjë ndodh për arsye objektive ose subjektive. Prandaj, mësuesi planifikon punën e tij të diferencuar në lidhje me metodat e mësimdhënies, me ecurinë e nxënësve gjatë gjithë procesit mësimor, si dhe me format e ndryshme të vlerësimit.

Mësuesi njihet mirë që në fillim me përbërjen e klasës së tij dhe me problemet që kanë nxënësit. Mësuesit kanë të bëjnë me adoleshentë dhe, për këtë arsye, ata ndeshen edhe me shumë probleme të moshës së tyre, si: temperament impulsiv, vrazhdësi në komunikim, ndonjëherë agresivitet, dorëzim apo heqje dorë para një detyre të dhënë etj.

Me qëllim që t'i tërheqë të gjithë nxënësit në mësim, mësuesi duhet të përdorë disa *teknika*, si:

- të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të ndajë përgjegjësitë dhe atëherë kur duhet për çështje vendimmarrjeje, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive.

Nxënësit kanë nevojë për një siguri profesionale dhe njerëzore në klasë, prandaj mësuesi përdor metoda të larmishme dhe gjithëpërfshirëse demokratike, duke siguruar një mjedis të rregullt brenda normave dhe rregullave të shkollës.

Më poshtë janë dhënë disa *sugjerime* se si mësuesi mund të nxisë nxënësit të punojnë në klasë dhe jashtë saj:

- shmang çdo gjë që nuk i përshtatet moshës së nxënësve;
- zgjedh materiale për mësim në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit mësimor;
- nëse diçka nuk ecën në klasë, përpiqet ta mënjanojë dhe të përdorë punën në grup ose, për individë të veçantë, punën individuale;
- përdor ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to;
- shmang ushtrime që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë;
- motivon nxënësin edhe për një detyrë fare të vogël që ka bërë, me qëllim që të rritet dëshira dhe përgjegjësia për mësimin e gjuhës së huaj;
- nuk i paragjykon nxënësit, por përkundrazi u jep ushtrime që kërkojnë vëmendje dhe punë.

## 7. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë t'i vlerësojë nxënësit për objektiva që nuk përmbahen apo nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënësit duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës sesa suksesi i arritur duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës.

Mësuesi monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësuesi përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

- *Vlerësimi i dijeve* (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çka është mësuar gjatë një jave, muaji, ose semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijes është i bazuar në orën e mësimin. Kështu ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm.
- *Vlerësimi i kapaciteteve* (ose i zbatimit të aftësive ose i performancës), që është vlerësimi i asaj çka nxënësit mund të bëjnë ose dinë, në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme. Ky lloj vlerësimi është pozitiv, për faktin se është më afër përvojës së nxënësit dhe i lejon secilit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme.
- Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: reciton, interpreton, prodhon një ese a shkrim tjetër etj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë duhet të mbajë parasysh komponentët e mëposhtëm:

- *Vlerësimi formues*, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënësi në formimin e tij gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.
- *Vlerësimi diagnostikues*, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai jep informacion, gjithashtu, për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.
- *Vlerësimi i planifikuar*, mbi bazën e realizimit të objektivave të nënlinjave, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.
- *Vlerësimi motivues*, ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënësit për mësimin e gjuhës italiane. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor, Mësuesi realizon këtë lloj vlerësimi duke gjetur shprehjet e duhura motivuese si psh Mirë, shume mirë etj dhe duke përdorur materiale që nxisin vlerësimin motivues të

nxënësit. Psh. përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënësit si pjese e Portofolit Evropian të Gjuhëve, ku ai vendos certifikata, provime, projekte, dëshmi etj që provojnë ecuri të tij në gjuhë.

- *Vlerësimi përfundimtar*, që është vlerësim me notë e që finalizon arritjet e objektivave të linjave dhe të nënlinjave për këtë grup-moshë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve dhe as vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektiv të veçantë të të nxënësit, deri tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi është në rolin e atij që drejton, që rekomandon.

### **Vetvlerësimi**

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës italiane, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi.

Vetëvlerësimi ka efekt kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grup-moshën e tyre dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian Gjuhëve(PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxësin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurikulare.



PEGJ është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGJ e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste dhe të vazhdojë t'i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGJ kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentin përfundimtar.

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.

Nxënësi mban shënim arritjet e tij, duke përdorur edhe gjuhën amtare.

Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënës të tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.